

79

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR KORCE
NR.REGJ.THEM. 437 prot.
DATA E REGJ. 12.10.2012

NR.VENDIMIT. 437 prot.
DT. VENDIMIT. 16.10.2012



VENDIM
"Ne emer te Republikes"

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Korçe e përbeere nga:

Glsi Xhavela- Gjyqtar i vetem

Asistuar nga sekretare Ernesta Cilja, ne Korçe sot me date 16.10.2012 mori ne shqyrtim materialin procedues qe i perket:

KERKUES: Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Korçe, perfaqesuar nga prokurori Elision Sadiku.

KUNDER TE DYSHUARIT: Artur Rakip, i biri i Nexhip dhe Vexhide, dtl.1966, banues ne Korçe.

AKUZUAR: Per kryerjen e veprës penale te "pastrimi i produkteve te veprës penale" parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

OBJEKTI: Caktim i masës së sigurimit me karakter pasuror "cekuastru preventive".

BAZA LIGJORE: Neni 274 i K.Pt.Penale.

Gjykata pasi degjoi pretendimet perfundimtare te Prokurorit, i cili kerkoi pranimin e kerkeses, si dhe pasi shqyrtoi ceshjen ne teresi:

VEREN

Ne daten 09.10.2010 ne Prokurorine e Rrethit Gjyqesor Korçe, nga ana e Drejtorise se Policise se Qarkut Korçe jane derguar materialet hetimore lidhur me veprën penale te "pastrimi i produkteve te veprës penale" parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, ne ngarkim te shtetasit Artur Rakip.

Nga aktet e administruara ne dosjen hetimore rezulton se shtetasi Artur Rakip është dënuar dy herë për veprat penale të "Fallsifikimit të letërnjoftimeve, pasaportave ose vizave", "Fallsifikimit të vulave stampave ose formularëve" dhe "Prodhimit të mjeteve për fallsifikim të dokumenteve, të parashikuara përkatësisht nga nenet 189/2, neni 190/2 dhe 192 të K.Penal. Kështu me vendimin nr. 210 dt 15.09.2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqesor Korçe, ky shtetas është dënuar me 7 (shtatë) muaj burgim, për veprën penale të parashikuar nga neni 189/1 i K.Penal

Me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqesor Tiranë nr. 920, dt 10.10.2006, shtetasi Artur Rakipi, në aplikim të nenit 55 të K.Penal dhe 460 të K.Pt.Penale, është dënuar përfundimisht me 1 (një) vit e 4 (katër) muaj burgim dhe 500 000 lekë gjobë, për



veprat penale të "Fallsifikimit të letërnjoftimeve, pasaportave ose vizave", "Fallsifikimit të vulave stampave ose formularëve" dhe "Prodhimit të mjeteve për fallsifikim të dokumentave, të parashikuara përkatësisht nga nenet 189/2, neni 190/2 dhe 192 të K.Penal. Nga përmbajtja e këtij vendimi rezulton se shtetasi Artur Rakip, ka qënë rregjistruar si pjesë e një grupi të strukturuar kriminal nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, për veprat penale të parashikuara nga nenet 298/3 dhe 28/4 të K.Penal. Me vendimin e datës 23.06.2006, të Prokurorisë së Krimeve të Rënda Tiranë, është pushuar hetimi për veprat penale penale, të parashikuara nga nenet 298/3 dhe 28/4 të K.Penal, është bërë ndarja e procedimit penal dhe është shpallur moskompetenca lëndore për këtë shtetas dhe të pandehur të tjerë, duke ju dërguar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kjo çështje penale në ngarkim të shtetasit Artur Rakipi dhe të pandehurve të tjerë, është dërguar për gjykim për veprat penale të përmëndura më sipër.

Nga përmbajtja e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton se shtetasi Artur Rakip, është marrë për një kohë relativisht të gjatë me veprimtarinë kriminale që perkon me veprat e "Fallsifikimi i letërnjoftimeve, pasaportave ose vizave", "Fallsifikimit i vulave stampave ose formularëve" dhe "Prodhimi i mjeteve për fallsifikim të dokumentave", të parashikuara përkatësisht nga nenet 189/2, neni 190/2 dhe 192 të K.Penal. Gjithashtu gjatë kontrollit të kryer në banesën e këtij shtetasi janë gjetur 252 pasaporta të shtetasve të ndryshëm, kapak pasaporte, 13 copë vula të ndryshme, 76 copë viza greke të paplotësuara, si dhe një sërë paisjesh për fallsifikim. Prova materiale të cilat, sipas vendimit të Gjykatës shiteshin nga ana e shtetasit Artur Rakip, për qëllime përfitimi.

Duke ju referuar faktit se veprat penale për të cilat është akuzuar dhe shpallur fajtor shtetasi Artur Rakip, janë vepra penale që janë kryer me qëllim përfitimi(thënë ndryshe që sjellin produkte të veprës penale sipas nenit 287 të K.Penal), nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, Drejtoria Kundër Krimit Financiar, është kryer një hetim financiar nga i cili ka rezultuar se:

-Për këtë shtetas dhe familjarët e tij, nuk ka raportime për deklarim të hollash në kufi.

-Nuk ka biznese të rregjistruara në QKR apo Tatime, por ka një sërë raportimesh nga bankat e nivelit të dytë për transaksione në vlera të konsiderushme, dhe më konkretisht:

- Në datë 01.09.2008, rezultoi një derdhje me para në dorë në "Alpa Bank", në shumën 164 680 euro, në emër të shtetasit Artur Rakip.
- Gjatë vitit 2009, rezultojnë transaksione për shuma, që variojnë nga 12 000 euro, deri në shumën 25 800 000 lekë. Nga këto transaksione evidentohet një derdhje me para në dorë më datë 15.01.2009, në shumën 24 250 euro.
- Gjatë vitit 2010, rezultojnë transaksione për shuma, që variojnë nga 269 000 lekë deri më 25 000 000 lekë.
- Më datë 26.05.2010, ka derdhur me para në dorë shumën prej 4 000 000 dhe e ka investuar në depozitë.
- Gjatë vitit 2011, rezultojnë transaksione që variojnë nga shuma 4 000 000 lekë, deri në shumën 419 000 dollarë të kryera në dy banka dhe më konkretisht Më datë 03.02.2011, ka tërhequr shumën prej 9 000 000 lekë. Më datë 15.03.2011, ka derdhur me para në dorë shumën 80 000 euro. Më datë 16.03.2011, ka derdhur me para në dorë shumën prej 102 000 dollarë. Po në datë 16.03.2011, ka derdhur me para në dorë shumën prej 69 740 dollarë tek "Banka Kombëtare Tregëtare". Më datë 14.07.2011, ka derdhur me para në dorë shumën 419 000 dollarë.

76

izave",
ve për
190/2
Rakip,
ria e
1/4 të
ënda
98/3
allur
guar
asit
e të

asi
le
",
tr
2
:
:

- Gjatë vitit 2012, ky shtetas ka kryer këmbime valutore nga euro në dollarë dhe lekë, shumën e derdhur më datë 14.07.2011, në "Bankën Kombëtare Tregëtare. Duke ju referuar faktit se shtetasi Artur Rakip, është marrë për një kohë të gjatë me veprimtari kriminale në fushën e fallsifikimit, me qëllim përfitimi, madje është dënuar dy herë nga Gjykatat për këtë fakt. Duke ju referuar faktit se nga hetimi financiar fillestar nuk rezulton që ky shtetas të ketë burime të ardhurash të tjera që të justifikojnë shumat deri në 419 000 dollarë, egzistojnë dyshime të arsyeshme se ky shtetas ka konsumuar dhe vazhdon të konsumojë veprën penale të "Pastrimit të produkteve të veprës penale", të parashikuar nga neni 287 I K.Penal.

Mbi kete baze, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korce ka filluar procedimin penal ndaj shtetasit Artur Rakip, për veprën penale të "pastrimi i produkteve të veprës penale" parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Me kërkesen objekt gjykimi, organi i akuzës kërkon caktimin ndaj tij të masës së sigurimit "sekuestro preventive" parashikuar nga neni 274 i K.Pr.Penale, duke pretenduar që shuma prej 40.000.000 leke e depozituar pranë Bankes Kombëtare Tregëtare në emër të shtetasit Artur Rakip, është produkt i veprave penale të kryara me parë prej tij dhe ka rrezik që disponimi i lire të kesaj shume, mund të rëndojë pasojat e veprës duke u tjetërsuar, transformuar, transferuar apo fshehur nga ana e të dyshuarit.

Gjykata pasi e mori rrethanat e çështjes, e mënjëherë e cmon se kërkesa e Prokurorisë duhet të pranohet sepse:

1-Ekziston dyshimi i arsyeshëm që shtetasi Artur Rakip ka kryer veprën penale të "pastrimi i produkteve të veprës penale" parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal", parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal, dyshim i cili bazohet në keto prova të administruara gjatë seances së caktimit të masës së sigurimit:

- Informacion mbi referimin e veprës penale i datës 09.10.2012.
- Vendim nr.210 datë 15.09.2003 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korce.
- Vendim nr.920 datë 10.10.2006 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Shkresë nr.16160/1 prot. datë 13.09.2012 e Q.K.R.
- Informacion i ardhur nga BKT me shkresën nr.6060/1 prot. datë 10.10.2012.
- Informacion i ardhur nga Alpha Bank në shkresën nr.10558 prot. datë 11.10.2012.

Nga teresia e provave të mesiperme, ekziston dyshimi i arsyeshëm se shtetasi Artur Rakip ka konsumuar elementet e veprës penale të "pastrimi i produkteve të veprës penale" parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, pasi nuk ekziston asnjë e dhënë që shumat e depozituara në emër të tij të burojnë nga një veprimtari ekonomike e ligjshme. Në të kundërt, sikurse u parashtrua më lart, i dyshuari në vazhdimësi ka ushtruar veprimtari kriminale duke konsumuar veprat penale për të cilat është dënuar me vendime të formës së prirë të gjykatës, vepra të cilat për nga natyra e tyre në raport edhe me rrethanat faktike, mund të kenë qenë burim i të ardhurave që ai disponon aktualisht, dyshim i cili mbetet të saktësohet gjatë hetimit të mëtejshëm të çështjes.

2-Lidhur me llojin e masës së sigurimit gjykata e mënjëherë e cmon se kërkesa e prokurorit për caktimin ndaj të dyshuarit të masës së sigurimit me karakter pasuror **sekuestro preventive** mbi shumën 40.000.000 (dyzetë milion) leke, e depozituar në llogari rrjedhese në emër të shtetasit Artur Rakip pranë Bankes Kombëtare Tregëtare, duhet të

2/6

pranohet, pasi ashtu sic u argumentua prej tij, kjo mase eshte e nevojshme per te parandaluar rrezikun e rendimit apo zgjatjes se pasojave te vepres penale, nepermjet disponimi te lire te kesaj shume, i cili mund te kryhet ne formen e tjetersimit, transformimit, transferimit apo fshehjes nga ana e te dyshuarit.

PER KETO ARSYE

Gjykata mbeshtetur ne nenet 253 dhe 238 te K.Pr.Penale

VENDOSI

1.Vendosjen e mases se sigurimit me karakter pasuror, **sekuestro preventive**, mbi shumen 40.000.000(dyzete milion) leke, e depozituar ne llogari rrjedhese ne emer te shtetasit Artur Rakip, i biri i Nexhip dhe Vexhide, dl.1966, prane Bankes Kombetare Tregtare.

2.Kunder vendimit mund te behet ankim ne Gjykatën e Apelit Korçe, brenda 10 diteve nga e nesermja e shpalljes se tij. Per te dyshuarin Artur Rakip, ky afat fillon nga dita e neserme e marrjes dijeni per vendosjen e sekuestros.

U shpall ne Korçe me date 16.10.2012.

SEKRETARE

ERNESTA CILJA



GJYQTAR

OLSI XHAYELLA



Shënim: Mbi ankim Gjykata e Apelit Korçë me vendimin Nr.67, datë 20.12.2012, ka vendosur:

Miratimin e vendimit nr. 437. Dt. 16.10.2012 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Korçe.

Shpenzimet gjyqesore ne mase 6.000 leke te parapaguara nga Gjykata e Apelit Korçe per avokatin e caktuar kryesisht Aleksander Dino, I ngarkohen shtetasit nen hetim.

Korçë, më 18.01.2013

KANCELAR